



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 842/19 Prot.

Tiranë, më 14 03 2023

VENDIM

Nr. 42 dt. 14 03 2023

“PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË MODELIN E DIPLOMËS, PËR PROGRAMIN E CIKLIT TË PARË TË STUDIMIT “BACHELOR” NË “SHKENCAT E REHABILITIMIT” NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË REHABILITIMIT”

Në zbatim të nenin 3 pika 2 gërma b, 38, 91 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në Udhëzimin nr.10 datë 30.03.2020 të MAS “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, i ndryshuar, në Udhëzimin nr.11, datë 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës”, në nenin 20, 81 pika 2 të Statutit të UST-së, në nenin 11 të Rregullores së UST-së, në shkresën nr.822 prot., datë 15.03.2023 “Për disa ndryshime në modelin e diplomës të ciklit të studimit Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit” në FSHR” të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit, Vendimit nr.17 datë 27.01.2023 të Senatit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.03.2023,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në modelin e diplomës në:
 - “Bachelor” në “Shkencat e Rehabilitimit” (formati bashkëngjitur)
2. Ky vendim t’i përcillet për njohje dhe zbatim Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Sherbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT
DEKANATI

Nr. 822 Prot.

Tiranë, më 19.03. 2023

Lënda: Për disa ndryshime në modelin e diplomës të ciklit të studimit Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit” në FSHR.

REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
PROF. DR. AGRON KASA

Në vijim të Udhëzimit e MAS, Nr.10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” i ndryshuar me Udhëzimin Nr.14, datë 21.06.2022, po ju përcjellim bashkëngjitur modelin e diplomës të ciklit të studimit Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit” në FSHR, me ndryshimet përkatëse.

Duke ju faleminderuar për bashkëpunimin,


DEKANI

Prof. Dr. Robert ÇINA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT



"BACHELOR"
NË "SHKENCAT E REHABILITIMIT (FIZIOTERAPI)"

I jepet

Z/Znj: _____, lindur në _____, datë: _____
(emri atësia mbiemri) (vendi) (data, muaji, viti)

në përfundim të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor", me kohë të plotë, 6 semestra, 180 kredite ECTS,
niveli I 6^{te}, referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Përfundoi studimet në datë: _____

ID e maturës shtetërore: _____

Nr. unik i identifikimit: _____

Nr. i matrikullimit të studentit: _____

Nr. i diplomës _____

Data e lëshimit të diplomës: _____

DEKANI

REKTORI

"Kjo diplomë shoqërohet nga suplementi i saj"